

1. Panairi Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore dhe Artizanatit



Në ditët e fundit të muajit shtator, në rrugët e Gjirokastrës së gurtë u zhvillua një panair kombëtar i trashëgimisë dhe artizanatit, i cili për dy ditë i dha zemrës historike të qytetit pamjen e një qendre tregtare mesjetare duke të sjellë ndër mend kohët e perandorisë osmane. Qëllimi i kësaj veprimtarie ishte promovimi i punës artizanale në Shqipëri, shkëmbimet ndërkombëtare në këtë fushë dhe një ngjarje turistike që do të ftonte vizitorët në

Qafën e Pazarit. Dhjetëra artizanë nga Gjirokastra, Shqipëria dhe Maqedonia paraqitën punimet e tyre artizanale, ndërsa qindra vizitorë i vizituan ato. U organizua edhe një tryezë e rumbullakët për të diskutuar gjendjen e artizanatit shqiptar, prej së cilës do të dërgohet një peticion organeve shtetërore për të kërkuar më shumë mbështetje për artizanatin, duke përfshirë edhe një kuadër ligjor më të favorshëm për zhvillimin e tij. Në të gjitha veprimtaritë mori pjesë edhe një delegacion nga Kosova. Është viti i dytë rresht që Panairi Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore dhe Artizanatit organizohet nga Organizata për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Gjirokastrës - GCDO. Këtë vit panairi u krye me mbështetjen e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në bashkëpunim me Bashkinë e qytetit. Qëllimi është që kjo veprimtari të bëhet e përvitshme si një mbështetje e qëndrueshme e artizanatit dhe turizmit vendor. Menjëherë pas Panairit Kombëtar të Trashëgimisë, në fillim të muajit tetor, GCDO morri pjesë në Panairin Ndërkombëtar të Mobilerisë i organizuar nga GTZ.



2 . Ngjarje kulturore në zonën historike si pjesë e Ditës Kombëtare të Trashëgimisë



Festivali Folklorik Ndërkombëtar i Gjirokastrës u zhvillua në skenën e hapur të “Odeonit” në të njëjtën kohë me Panairin e Artizanatit. Dhjetë grupe folklorike nga Shqipëria, Kroacia, Italia, Greqia, Kosova dhe Maqedonia morën pjesë në një festival, i cili tërhoqi një audiencë të gjerë nga e gjithë Shqipëria.

Ndërsa Shoqata “Argjiro” organizoi në Kala veprimtarinë muzikore “ Takim i Dy Botëve“, një varg koncertesh me muzikë klasike. Në Galerinë e Arteve të Kalasë u hap ndërkohë ekspozita e piktorit të njohur gjirokastrit Bashkim Ahmeti.



3. Kampi i dytë ndërkombëtar restaurator në Gjirokastrë



40 studentë nga vende të ndryshme të Ballkanit dhe Suedia morën pjesë për më se dy javë në një “ kamp restaurimi ” që u zhvillua në Gjirokastrë në mesin e muajit shtator. Kampi kishte për qëllim shkëmbimin e përvojës në dokumentimin dhe konstruksionin e ndërtesave karakteristike të Gjirokastrës, para se ato të restaurohen. Këtë vit kampi u fokusua në dy godina (një e kategorisë A dhe tjetra e kategorisë B) të

familjes Babameto, duke përgatitur për këto godina rievime teknike. Përpara fillimit të studimit, u bë një përpjekje e madhe për pastrimin e këtyre godinave (si dhe godinës së familjes Shahu) nga mbeturinat. Rilevimi i tyre është hapi i parë që do i paraprijë përgatitjes së projekteve restauruese dhe rivënies në përdorim të tyre. Kampi është një projekt i përbashkët i organizatës Trashëgimi Kulturorë pa Kufij, Universitetit Mbretëror të Arteve të Bukura të Suedisë dhe GCDO-së, mbështetur nga SIDA - Agjencia Suedeze e Zhvillimit dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar. Instituti i Monumenteve të Kulturës në Tiranë, një partner aktiv i aktivitetit, u prezantua nga prof. Emin Riza.

4 . Këshilli Kombëtar i Restaurimeve miratoi projektet për ndriçimin e Kalasë së Gjirokastrës me panele diellore dhe vendosjen e tabelave shpjeguese

Këto janë 2 projekte të rëndësishme: projekti i parë ka të bëjë me galerinë hyrëse, e cila do të ndriçohet përmes energjisë së siguar nga panele diellore të vendosura në tarracën e Kalasë (projekti bashkëfinancohet nga GCDO dhe **GEF**). Projekti tjetër do të bëjë interpretimin e Kalasë: të dy projektet së bashku do të përmirësojnë shumë eksperiencën e vizitorëve. Projektet të financuara nga Philanthropic Collaborative në New York parashikohen të përfundojnë brenda vitit. Ndërkohë GCDO ka vazhduar programin për të pastruar muret dhe brendësinë e Kalasë nga bimësia e dëmshme.

5 . “Kronikë në Gur” një muze i ri në Kalanë e Gjirokastrës

Projekt - propozimi për të ndërtuar një muze të ri në Kala mori formën e plotë. Muzeu, përkohësisht i quajtur “Kronikë në Gur”, synon t'i bëjë një paraqitje interesante historisë së veçantë të Gjirokastrës dhe rrethinave të saj, duke u mbështetur në koncepte moderne të muzeologjisë së sotme. Ai mendohet të jetë një epiqendër për vizitorët në rajon duke ndihmuar ata të informohen për të gjitha aspektet e historisë së tij shoqërore, kulturore dhe politike. Një projekt - propozim i detajuar është publikuar tashmë dhe gjatë vjeshtës do të fillojë fushata për gjetjen e fondeve për ndërtimin e tij, bashkë me qeverisjen lokale dhe atë qendrore. Një kopje elektronike të tij mund ta gjeni bashkë me buletin informativ (si në versionin shqip dhe anglisht), ndërsa kopje të shtypura mund të sigurohen nga GCDO.



6. Projekti i restaurimit të shkallëve

Shkallët që ndodhen pranë shkollës së mesme “Asim Zeneli” në Gjirokastrë do të restaurohen dhe do të shtrohen përsëri me kalldrëm. Projekti i financuar nga GCDO dhe Bashkia e qytetit do ta përmirësojë këtë zonë, e cila ka qenë e mbuluar me mbeturina betoni dhe zhavorr. Kjo rrugëz do të marrë një pamje të re duke u bërë një pikë lidhjeje në pjesën historike të qytetit dhe do t'i japë akses Shtëpisë së Zekateve dhe Muzeut Etnografik.



7. Një vit më i mirë për turizmin në Gjirokastrë: 135 % turistë më shumë gjatë muajit shtator në Gjirokastrë



Mbi 10,000 turistë vizituan Gjirokastrën gjatë periudhës janar - tetor 2008. Sipas statistikave të Zyrës për Informin Turistik dhe Kalasë së qytetit, shtatori është muaji me numrin më të madh të turistëve për këtë vit me një rritje prej 135% krahasuar me shtatorin e vitit të kaluar. Fotoja e marrë në Galerinë e Artit të Kalasë së Gjirokastrës tregon pasurimin e origjinës gjeografike së turistëve që vizitojnë Gjirokastrën. Gjatë vizitës në kala vizitorët nga Japonia siç

mund të shihet edhe në foto performojnë një vallzim tradicional.

Ndërkohë, restaurimi i Pazarit dhe i godinave të tjera të rëndësishme në Gjirokastrë do të rrisë atraksionet e qytetit. Një shenjë e mirë është hapja e një dyqani të ri në Pazar nga Shoqata e Artizanëve të Antigonesë. Kjo shoqatë administron një punishte të vogël ku prodhohen produkte prej leshi, e ngritur me mbështetjen e një organizate norvegjeze dhe tregton qilima, shaje, triko, dhe çanta të prodhuara nga teknika tradicionale.



8. Mbështetje nga shtypi i huaj dhe promovim më i mirë i Gjirokastrës

Si pjesë e përpjekjes së tyre për të promovuar Shqipërinë, GCDO së bashku me partnerët e Fondacionit Butrinti mirëserdhën gazetarin britanik David Aaronovitch në Butrint dhe Gjirokastrë. Vizita e tij, e cila ishte e koordinuar me USAID/EDEM, shënoi një sukses të plotë dhe u kurorëzua me një artikull shumë pozitiv të gazetarit britanik për Shqipërinë. Linku URL

<http://www.timesonline.co.uk/tol/travel/destinations/europe/article4782605.ece>.



Gjithashtu në bashkëpunim me USAID / Shqipëri, GCDO pati një takim me anëtarët e një grupi vlerësues nga Aleanca e Mbështetjes së Turizmit Global (GSTA), të cilët vizituan Gjirokastrën dhe rajonin përreth, për të paraqitur rëndësinë e turizmit, sektorit privat në zonën përreth, si dhe nevojat e banorëve për të përmirësuar sistemin e turizmit në Shqipëri. Grupi vlerësues i GSTA merret me ekzaminim e

problemeve të qeverisjes ekonomisë, të shoqërisë civile dhe ato mjedisore, për të influencuar mbi zhvillimin e turizmit në Shqipëri. Ky grup vizitoi Gjirokastrën dhe zonat përreth saj si Asim Zenelin, Antigonenë dhe Saraqinishtën, duke i identifikuar ato si zona me një potencial të konsiderueshëm për zhvillimin e turizmit. Grupi i GSTA i përfaqësuar nga Jim Phillips, Gary Lazor, Juan Luna si dhe nga Nevila Popa shprehën mirënjohjen e tyre për ndihmesën e dhënë nga GCDO.

Përveç këtij takimi, në 18 tetor, GCDO mirëpriti një grup prej 35 gjeografësh nga Holanda të cilët vizituan Shqipërinë me qëllim përmirësimin e botimit “In your pocket guide” për Shqipërinë. Qyteti i Gurtë ishte një nga qytetet më tërheqës si pjesë e itinerarit turistik në Shqipëri. *“ Të gjithë pjesëmarrësit mbetën të kënaqur nga vizita, dhe jam i sigurt se ata do t’ju rekomandojnë familjeve dhe miqve të tyre të vijnë dhe të vizitojnë Shqipërinë. Udhëtimi ynë ishte shumë i suksesshëm si rezultat i informacioneve që ju na përcollët si dhe kontaktet me vendasit - ju falënderojmë për kohën që i kushtuat grupit tonë për të kuptuar sa më mirë Shqipërinë.”* Kështu ka shkruar udhëheqësi i grupit. Jeroen Van Marle, për GCDO dhe Zyrën e Informimit Turistik në Gjirokastrë.



9. Një udhëtim me këmbë Gjirokastër- Antigone

Anëtarë të GCDO - së janë ngarkuar për të realizuar projektin mbi krijimin e një shtegu këmbësorësh që lidh Gjirokastrën si pjesë e UNESCO me parkun arkeologjik të Antigonesë dhe që ka një kohëzgjatje prej dy orësh. Ky shteg është përcaktuar me ndihmën e GPS-sit dhe do të shënjohej me panelet interpretuese tek vendet kyçe. Qëllimi i saj është që të sigurojë një udhëtim të pëlqyeshëm si nga pjesëtarët e komunitetit, ashtu edhe nga turistët. Ky udhëtim është një përpjekje nga ana e GCDO – së për të integruar dhe mbështetur zhvillimin e eko - turizmit në këtë zonë.

10. Vullnetari i ri i Korpusit të Paqes mbërrin në GCDO

GCDO është krenare të bëjë të ditur mbërritjen e vullnetarit të ri të Korpusit të Paqes, Allan Zaretsky, i cili u bë pjesë e stafit të GCDO –së në fillim të tetorit. Korpusi i Paqes është një iniciativë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për të shpërndarë qytetarë vullnetarë të punojnë si mësues, profesionist për kujdesin e shëndetit, si dhe konsulentë në zhvillimin organizativ të rretheve. Allan do të punojë për organizatën deri në verën e vitit 2010. Ai filloi shërbimin e tij në Republikën e Gjeorgjisë, por për shkak të konfliktit me Rusinë u largua dhe u caktua të punojë për GCDO në qytetin e Gjirokastrës. Me origjinë nga New York-u, ai është diplomuar për shkencë politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare në universitetin e Northwestern në Chicago në vitin 2005. Përpara se të bashkohej me Korpusin e Paqes, ai ka punuar si organizator unioni në New York dhe Connecticut. Ai është shumë entuziast që do të ndihmojë GCDO në përmbushjen e objektivave të saj, konservimin dhe promovimin e Gjirokastrës historike.

Faleminderit !

**Për më shumë informacion rreth GCDO-së dhe përpjekjeve të saj në Gjirokastër, lutemi drejtojeni drejtorit Sadi Petrela në spetrela@gjirokastra.org ose në cel 06920 78767.*